



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272471
Datë: 08.08.2024
Numri i dokumentit: 06033473

AC-I-23-0209

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

O S, - të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat B I, Prishtinë.

kundër

E paditura

NSH, "Famipa" Prizren (në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1700 të datës 21 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 08 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

Ankesa e paditësit e datës 07 prill 2023, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV.-15-1700, të datës 21 mars 2023, konsiderohet e tërhequr.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 10 shtator 2015, paditësi e ka dorëzuar një parashtrësë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0156 i datës 02 shtator 2013 me të cilin AL i kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 1,920.00 euro, me arsyetim se për periudhën para lidhjes së Kontratës së privatizimit i njëjti nuk ka qenë punëtor aktiv në ndërmarrje, nuk ka qenë në listën e pagave dhe nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në, andaj ai nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.1 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, që ti njihet e drejta në pagesën e pagave të pa paguara. Paditësi ndër të tjera ka theksuar se NSH Famipa ka qenë ndërmarrje e cila është privatizuar me datën 16 shtator 2011, me rastin e privatizimit paditësi ka qenë punëtor aktiv dhe në të njëjtën datë e paditura ia ka ndërprerë kontratën e punës. Pranë Autoritetit të Likuidimit me kohë ka parashtruar kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara dhe se autoriteti i Likuidimit kërkesën e parashtruar e kishte refuzuar si të pa bazuar. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që padinë e parashtruar ta aprovojë si të bazuar te anulohet vendimi kontestues dhe te detyrohet pala e paditur që t'ia kompensojë shumën 1,920.00 euro, në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës në ndërmarrje, me normë të kamatës prej 10% e cila fillon të rrjedhë nga data 21 shtator 2011 e deri në datën 03.06.2013, ndërsa nga data 10 korrik 2013, e deri me datën 10 shtator 2015, me normë të kamatës prej 8%.

Me 02 mars 2023, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht, objekt i shqyrtimit në këtë çështje juridike është ligjshmëria e vendimit të nxjerrë nga Autoriteti i likuidimit dhe se parashtruesi i padisë nuk ka treguar se cila dispozitë e ligjit me numër 04/L-034, është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit.

Tutje AKP-ja pohon se sipas listës së pagave të punëtorëve, paditësi nuk ka punuar dhe nuk ka ofruar shërbime për NSH-në, ai nuk ishte punëtorë aktiv i NSH-së, prandaj nuk ka të drejtë pagese në tri paga të pretenduara ndaj NSH-së. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që padinë e parashtruar nga i njëjti ta

refuzojë si të pa pranueshme dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit nr.06/L-086.

Me 21 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-15-1700, ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me numër PRZ024-0156, të datës 02 shtator 2013 si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Me 07 prill 2023, paditësi (në tekstin e mëtejme ankuesi) nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të DHPGJS, C-IV-15-1700 të datës 21 mars 2023. Ankuesi e kundërshton aktgjykimin e atakuar, për të gjitha bazat ankimore dhe ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar të anulohet Aktgjykimi i atakuar dhe të obligohet AKP që në emër të kompensimit të borxhit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës t'i paguajë ankuesit shumën e borxhit kryesor prej 1,920.00 euro në emër të 6 pagave për përvojën e tij të punës prej 20 vjetëve ashtu siç është kërkuar në kërkesës ose shumën prej 1,020.00 euro duke u bazuar në pagën minimale në Kosovë në vitin 2011, si dhe kamatën prej 10% e paraparë me Ligjin e AKP-së dhe shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Me 22 maj 2023, zyra e i financave të DHPGJS i ka lëshuar vërejtje paditësit/përfaqësuesit të paditësit, për pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar atë për pasojat e mos përgjigjes. Përfaqësuesi i paditësit vërejtjen për taksë e ka pranuar me 23 maj 2023, por ai nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësore.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit konsiderohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Apelit vëren se me dt. 22 maj 2023, zyra e i financave të DHPGJS së Shkalles së II-të i ka lëshuar vërejtje paditësit/përfaqësuesit të paditësit, për pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar atë për pasojat e mos përgjigjes. Përfaqësuesi i paditësit vërejtjen për taksë e ka pranuar me 23 maj 2023, por ai nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësore.

Kolegji i Apelit vlerëson se konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së, paditësi ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar. Dispozita e nenit 253.5, parasheh: *“Në qoftëse se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”.*

Paditësi ka për obligim ti paguajë taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 60 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr.01/2017, lidhur me taksat gjyqësore. Vërejtja ishte pranuar nga përfaqësuesi i paditësit, më datë 23 maj 2023, mirëpo ai nuk ka bërë pagesën e taksës dhe as nuk ka paraqitur kërkesë për lirim nga pagesa e taksës brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri më vendosjen e këtij Aktvendimi.

Kolegji i Apelit vëren se paditësit/ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të Kolegjit, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditësit konsiderohet e tërhequr.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Taksa gjyqësore

Ankuesi nuk e ka pagur taksën gjyqësore për këtë procedurë ankimore.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 08 gusht 2024.

Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar, Gjyqtar kryesues _____